



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.22, datë 30.01.2023

PËR

“TRANSFERIMIN E PËRHERSHËM TË PROKURORËVE NGA PROKURORITË PRANË GJYKATAVE TË APELIT, NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM, PËR EFEKT RISTRUKTURIMI”

Bazuar në nenin 149/a pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 44 pika 1, germa “b” dhe pika 2 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, pikën 2 të VKM-së Nr.495, datë 21.7.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Prokurorët e emëruar/caktuar në mënyrë të përhershme në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë qëndrojnë në pozicion në strukturën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
2. Prokurorët e emëruar/caktuar në mënyrë të përhershme në Prokuroritë pranë Gjykatave të Apelit Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, të cilëve ju suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit gjyqësor, transferohen prokurorë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
3. Nërprejten e caktimit të përkohshëm në prokuroritë pranë Gjykatave të Apelit që shkrihen, të prokurorëve Elida Hoxhaj, Kleanth Zeka dhe Pranvera Gruda.
4. Të njoftohen për këtë vendim, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, zonja Elida Hoxhaj, zoti Kleanth Zeka dhe zonja Pranvera Gruda.
5. Ky vendim hyn në fuqi me datë 01.02.2023 dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 30.01.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Alfred Balla

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj



ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Elaida Goxhi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

